



Viti i IX-të i Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2018

PARAQITJET DHE KOMUNIKIMET NË MATEMATIKË: MUNDËSITË QË OFRON MOODLE

Lekë Pepkolaj*, Genta Rexha*

*Departamenti i Inxhinierive, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Albanian University

Adresë kontakti: l.pepkolaj@albanianuniversity.edu.al

Përmbledhje

Qëllimi i këtij punimi është të theksojë disa nga mundësitë e ofruara nga *e-learning*, në veçanti nga platforma informatike Moodle, që lidhen me paraqitjet dhe komunikimet në edukimin matematik. Në fillim diskutohen shkurtimisht lidhjet ndërmjet paraqitjes, komunikimit dhe edukimit matematik, duke u përqendruar në dy ide që janë themelore në edukimin matematik: multisemiotizimi dhe multivarieteti. Në fund, janë përshkruar dhe diskutuar nga ana e perspektivave të paraqitjes dhe komunikimit të koncepteve dhe procedurave matematikore, mundësitë e disa prej veprimtarive të arritshme në platformën Moodle.

Fjalë çelës: *multisemiotizimi, multivarieteti, kuiz, detyrë, leksion.*

REPRESENTATIONS AND COMMUNICATIONS IN MATHEMATICS: THE POSSIBILITIES OFFERED BY MOODLE

Abstract

The goal of this paper is to highlight some opportunities provided by e-learning, and in particular by the Moodle platform, linked to the representation and communication in mathematics education. At first, the relationship between representation, communication and mathematics education are shortly discussed, focused on two ideas that are the base of mathematics education: multisemioticity and multivariety. Then, the potential of some of the activities available on the Moodle platform are outlined and discussed, from the perspective of representation and communication of mathematical concepts and procedures.

Key words: *multisemioticity, multivariety, quiz, task, lesson.*

1. Hyrje

Është e qartë se teknologjia jep mundësi të mëdha mbi planet e paraqitjes së njohurive. Kjo vlen qoftë për studentit që vepron në klasë ose në shtëpi, qoftë për pedagogun, i cili mund të përdorë paraqitje të ndryshme nga ato të një leksioni në prani. Një numër i madh studentësh tregon që nuk kupton në mënyrë të përshtatshme një tekst verbal të shkruar, shkurt dhe thjesht, ose nuk është në gjendje të krijojë një tekst të qartë dhe të plotë. Këto vështirësi kanë ndikim jo të vogël te nxënia. Mundësitë paraqitëse të platformës Moodle lejojnë të punohet duke përdorur një shumëllojshmëri të sistemeve semiotike (për shembull, shënime algjebrike, grafikë, tabela, tekste verbale etj.). Kjo platformë lejon në veçanti të realizohen shënime, leksione, kuize, detyra, përmbledhje dhe materiale të tjera, në të cilat sistemet e ndryshme semiotike përdoren në mënyrë të kombinuar për të pasuruar ofertën didaktike dhe për ta bërë më të përshtatshme për përdoruesit. Kërkimi shkencor në edukimin matematik ka treguar mundësitë kognitive të përdorimit të koordinuar të shumë sistemeve semiotike [1, 2].

2. Sistemet semiotike, paraqitja dhe komunikimi

Proceset e paraqitjes dhe të komunikimit janë të ndërlidhura ngushtë me njëri-tjetrin dhe me proceset e dijes [3, 4, 5, 6]. Proceset e dijes varen nga ato të komunikimit, dhe këto të fundit kërkojnë praninë e një sistemi shenjash [7]. Një nga karakteristikat e matematikës është prania dhe rëndësia e një game të gjerë sistemesh semiotike, nga gjuha verbale (gjuhët) deri te shënimet simbolike dhe ato të paraqitjeve figurore.

2.1 Multisemiotizimi

Në këtë punim, ne do të marrim parasysh tri grupe sistemesh semiotike [1, 8]:

- gjuhën verbale,
- shënimet simbolike,
- paraqitjet figurore.

Në analizën e ndërveprimeve midis këtyre sistemeve, dhe gjithashtu midis formës së shkruar dhe të folur të gjuhës verbale, ne do të mbështetemi te disa kontribute klasike të Duval [2, 7].

Ndryshe nga sistemet e tjera semiotike, roli i gjuhës verbale është thelbësor, për disa arsye:

- është reflektuese (që është në gjendje të flasë për veten),
- është në gjendje të klasifikojë realitetin, edhe në një mënyrë të përafërt dhe jozyrtare,

- ndërton përvojën njerëzore dhe e bën atë të transmetueshme, si dhe artikulon zërat e ndryshëm të një kulture.

Prania e një gamë të gjerë larmishmërie gjuhësore, nga ato që janë qartësisht bashkëbiseduese me ato më të zhvilluara (siç do ta shohim në paragrafët e ardhshëm), është një faktor tjetër që e bën gjuhën verbale të pazëvendësueshme.

Multisemiotizimi është përdorimi i sistemeve të ndryshme semiotike edhe njëkohësisht. Mundësia e realizimit të tyre në një platformë, do të jetë një nga temat kryesore të këtij punimi.

Roli i shënimeve simbolike të matematikës është më delikat dhe kontradiktor. Megjithatë, duhet të theksohet se një analizë funksionuese e këtij sistemi semiotik nuk mund të përqendrohet vetëm në analizën e funksionimit real që i përcaktohen këtyre nga disa qasje filozofike [1]. Në këtë punim, shënimet simbolike konsiderohen si mjete për të përshkruar në mënyrë sistematike korpusin e njohurive matematikore, duke mbështetur vendosmërinë e koncepteve dhe gjetjen e procedurave, dhe jo si garantues i një ashpërsie të pakalueshme. Kjo lidhet gjithashtu me përdorimin e dyanshëm të tyre dhe për këtë arsye ka rendësi interpretimi i disa komponentëve themelorë të matematikës, siç janë vërtetimet.

Është përtej diskutimit se në bagazhin e një studenti duhet të jetë aftësia për të interpretuar një paraqitje figurore (një grafik ose një histogramë). Është gjithashtu e arsyeshme të mendosh se aftësia për të koordinuar paraqitje të ndryshme që i referohen të njëjtës fushë disiplinore është një ndihmë e fuqishme për të kuptuar, edhe nëse përvojat e deritanishme tregojnë vështirësitë e mëdha të një rruge që synon këtë qëllim. Këto vështirësi kanë të bëjnë me sferën gjuhësore, sferën kognitive dhe gjithashtu, në një mënyrë të thellë me bindjet dhe qëndrimet e subjekteve [9].

Burime të ndryshme dhe veprimtari të pranishme në një platformë mundësojnë veprimtari multisemiotike, edhe pse multisemiotizimi i teksteve duhet të programohet në mënyrë të qartë. Kjo vlen, në veçanti, në Moodle, për modulet *Quiz*, *Lesson* dhe *Task*. Në paragrafin 3 do të ilustrohen disa shembuj të përdorimit të secilës prej këtyre veprimtarive, tamam për të verifikuar dhe ndërtuar aftësinë e përdorimit më të mirë të shumë sistemeve semiotike në dispozicion, nga këndvështrimi i asaj që Duval e quan koordinim të sistemeve semiotike.

2.2 Multivariateti

Aspekti tjetër i rëndësishëm do të jetë multivariateti, që është përdorimi i regjistrave të ndryshëm të gjuhës verbale në të dyja veprimtaritë, si të komunikimit dhe të ndërveprimit [8]. Vetëdija dhe mundësia e përdorimit të regjistrave të ndryshëm të gjuhës verbale (ose përdorimi i shënimeve simbolike, ose paraqitjeve figurore në një mënyrë pak a shumë formale) është një mjet shumë

i fuqishëm njohës. Ndoshta në këtë dialektikë duhet të kërkojmë mënyra se si gjuha mbështet mendimin [1].

Sipas Halliday [10] gjuha e mbështet mendimin nëpërmjet zhvillimit të formave që u lejon për të shkuar përtej teksteve fortësisht ikonike (domethënë, të lidhura ngushtë me strukturën e fakteve) derisa të arrijmë te tekstet që janë plotësisht të ristrukturuara dhe kompakte përmes gramatikës. Gramatika lejon të ndërtohen shprehje që i referohen kuptimeve abstrakte, për të nxjerrë në pah lidhjet që interesojnë dhe lënë pas dore të tjerat, si në ndërtimin e metaforave. Tamam për këtë analogji me metaforat, Halliday flet për metaforë gramatikore. Në këtë mënyrë ai thekson se si gjuha metaforike ndërtohet jo vetëm nëpërmjet ndryshimeve leksikore (si në metaforat e zakonshme), por edhe përmes ndryshimit të organizimit gramatikor të tekstit. Duhet thënë se Halliday, kur flet për metaforat, është veçanërisht e interesuar në procesin përmes të cilit një kuptim shprehet në mënyra të ndryshme (qoftë leksikografikisht, qoftë gramatikisht), në vend të kësaj, ajo e studiuar më shumë në gjuhësi, përmes të cilës e njëjta shprehje kalon nga një kuptim ikonik në një metaforik. Është e qartë se në matematikë kemi nevojë për regjistra (gjuhë verbale e shumëllojshme) bashkëbisedues, për të ndërtuar koncepte pa shumë kujdes në formën e paraqitjes së tyre, qoftë atyre të evoluar (pra edhe të shënimeve simbolike, të cilat kanë një funksionim që i bën ato forma ekstreme të regjistrave të evoluar). Regjistrat e evoluar janë të domosdoshëm për të shprehur lidhjet midis koncepteve matematikore, përgjithësimeve dhe procedurave të zgjidhjes. Është provuar se shumë nga gabimet e studentëve mund të evidentohen në përdorimin e formave tipike të regjistrave bashkëbisedues në rastet kur nevojiten forma më të evoluara [9].

3. Rasti Moodle

3.1 Moduli *Quiz*

Në modulën *Quiz* çdo *item* – element (stimul, pyetje, problemë, ...) mund të përfshijë tekste verbale, shprehje simbolike, imazhe. Përgjigja e studentit shumë shpesh konsiston në një ose më shumë klikime në pozicionet në ekran. Në disa raste (përgjigje numerike, përgjigje e shkurtër ...) studentit i kërkohet të përpunojë një tekst, verbal ose simbolik.

Veprimtaria *Quiz* lejon të futen elemente me përgjigje të mbyllur (zgjedhje të shumëfishta, të vërteta/të rremë, korrespondenca, ...) ose të hapura. Në rastin e fundit, është e rëndësishme ndryshimi midis elementeve në të cilat përgjigja është një numër ose një tekst prej 1-2 fjalësh dhe atyre në të cilat përgjigja kërkon një tekst më kompleks. Në rastin e parë (si për element me përgjigje të mbyllur) është e mundur që të ketë vlerësimin automatik të përgjigjeve, në rastin e dytë vlerësimi automatik bëhet më i vështirë për t'u realizuar.

Moduli *Quiz* me elemente me përgjigje të mbyllur ose numerike në Moodle (dhe në platforma të tjera ku është i pranishëm) ofron përparësi të mëdha, të tilla si përdorim të lehtë nga studentët, mundësi për të marrë një vlerësim të menjëhershëm dhe faktin se veprimtaria një herë e kryer mund të përdoret gjithashtu në mungesë të një udhëheqësi (mentori). Megjithatë, ka kufizime. Një vështirësi lidhet me faktin se studentëve nuk u kërkohet të krijojnë një tekst ose një paraqitje, ku aftësia për ta bërë këtë është një objektivi që s'mund të hiqet në edukimin matematik. Një vështirësi e dytë rrjedh nga fakti se studentëve nuk u kërkohet të krijojnë procedurën për zgjidhjen e një problemi dhe as për të krijuar një pyetje, por vetëm për të zgjedhur midis disa opsioneve. Nuk është e vështirë të mendohen shembuj pyetjesh ose problemesh në të cilat versionet me përgjigje të hapura dhe ato me zgjedhje të një përgjigjeje nga disa, kërkojnë njohuri, procese dhe strategji krejtësisht të ndryshme. Duke pasur përpara një zgjedhje me 4 - 5 përgjigje në vend të një flete bosh, ofron informacion, që ngushton fushën e mundësive dhe lejon marrje njohurish që mund të mos jenë njohuritë e temës dhe varet shumë nga cilësia e ngatërruesve.

Vështirësia e parë është e pakapërcyeshme dhe duhet të trajtohet me mjete të tjera, e dyta mund të kapërcehet, të paktën pjesërisht, me anë të një zgjedhje të mirë të elementeve (dhe ngatërruesit përkatës), që kërkojnë për ata që përgjigjen, një kuptim të mirë të koncepteve të përfshira dhe pengojnë lojën e implikimeve dhe përpjekjeve për t'u përgjigjur rastësisht. Një zgjedhje e ngatërruesve që i përgjigjet kritereve të simetrisë, ose plotësisë, jep në mënyrë të pashmangshme të dhëna për një zgjidhës të zgjuar. Duke patur parasysh se përdorimi i këtyre mjeteve është kryesisht formativ, rreziku nuk është aq shumë për të shtrembëruar një vlerësim, sesa arritja te përdoruesit e informacioneve të gabuara në përgatitjen e tyre. Veçanërisht në lidhje me çështjet e këtij lloji, është e përshtatshme që në të gjitha rastet ku është e mundur, të jetë i pranishëm mes opsioneve një zë i tipit “Asnjë nga përgjigjet e tjera ose të mëparshme nuk është e saktë”, ose “Tjetër” dhe kjo është përgjigja për t'u zgjedhur në një numër të përshtatshëm të rasteve. Kjo nuk do të pengojë vlerësimin automatik të rezultateve, pasi përgjigja e duhur nuk kërkohet, por jep informacion mbi aftësitë kritike të përdoruesve dhe dekurajon strategji të papërshtatshme, ato që Vinner i quan ‘pseudoanalitike’ [11].

3.2 Task

Moduli *Task* (detyrë) konsiston në një stimul të propozuar (një pyetje, një problemë, një tekst që do të analizohet, ...), të cilët studentët i përgjigjen me paraqitjen e një skedari në çdo format, plotësimin e një moduli *online* ose në tjera mënyra që kërkon përpunimin e një teksti ose hiperteksti. Si teksti i detyrës, ashtu edhe përgjigja mund të përfshijnë tekste verbale, shprehje simbolike dhe paraqitje figurore.

Pedagogët mund të vlerësojnë produktin, të komunikojnë rezultatet e vlerësimit për secilin student, dhe përkatësisht të kërkojnë një paraqitje të re të përgjigjes. Në këto veprimtari, si dhe në të tjerat, është e mundur që të vendosen kufizime kohore për mundësinë që studentët të shohin tekstin e detyrës dhe paraqitjen e përgjigjes. Është gjithashtu e mundur t'i nënshtrohen leximit përfundimet e veprimtarive të tjera. Këto mundësi mund të shfrytëzohen për t'i nxitur studentët që të qëndrojnë në kontakt me kursin, për shembull me detyra që kërkojnë reflektim mbi argumentet paraprake në lidhje me temat e trajtuara në një leksion, me detyrimin për t'i kryer ato në ditët që e paraprijnë atë.

Një pedagog i vetëm vështirë se mund të bëjë një punë si kjo për një klasë me numër të madh studentësh, dhe jo vetëm për disa probleme në javë, pra do të duhej një ekip me disa udhëheqës së bashku me pedagogun. Një kurs me njëqind pjesëmarrës do të kërkonte 6-7 udhëheqës me kohë të pjesshme, ose 2-3 me orar të plotë. Nga ana tjetër është e nevojshme të përdoret një numër i caktuar detyrash për të integruar kuizet me përgjigje të mbyllur duke balancuar kufizimet e theksuara në paragrafin e mëparshëm.

3.3 Lesson

Veprimtaria *Lesson* (leksion), e pranishme në Moodle, lejon të ndërtohen drejtime të degëzuara në të cilat studentëve u paraqiten materiale, në formate të ndryshme (tekst, prezantime në *power point*, video etj...), me mundësinë e futjes së pyetjeve verifikuese në fund. Në rast të kalimit të testit studentëve ju jepen materiale të tjera, në rast të mos kalimit të testit, mund të drejtohen drejt aktiviteteve rikuperuese, gjithashtu të krijuara në varësi të gabimeve të kryera ose afrohen për të rishikuar materialet ose për të konsultuar ndonjë përmbledhje ose materiale të tjera referimi.

Leksioni lejon të projektohen veprimtari të integruara të nxënies, verifikimi i të cilit mund të përfshijë nivele të ndryshme: kuptim i saktë dhe i thjeshtë i teksteve, ato të përmbajtjes, ato të procedurave dhe vetëdijes metakognitive.

Nga pikëpamja e komunikimit dhe e gjuhëve, leksioni mund të përfshijë një gamë shumë të gjerë paraqitjesh, nga tekstet verbale të shprehjet simbolike, nga imazhet të filmimit. Mundësitë e *feedback*-ut për studentët janë pothuajse të njëjta me kuizet.

4. Përfundime

Në këtë punim kemi kërkuar të japim një kuadër sintetik të përparësive dhe mundësive që ofrojnë platformat informatike për të përmirësuar mësimdhënien e matematikës. Pjesa më e madhe e përparësive dhe kufizimeve të diskutuara në këtë punim nuk janë vetëm të platformave, por edhe të instrumenteve dhe mjeteve të tjera teknologjike. Platformat japin mundësinë për të përdorur dhe

kombinuar këto përparësi edhe në mënyrë didaktike. Shfrytëzimi i këtyre mundësive nuk është i menjëhershëm dhe i lehtë, por kërkon angazhim të madh të kërkimit shkencor. Një nga pikat kritike të përdorimit të platformave është largësia e madhe midis përparësive të tyre në aspektin teorik dhe realizimit, përdorimit real të tyre. Prandaj është e përshtatshme t'i kushtohet shumë vëmendje praktikës së hipotezave të ndryshme të përdorimit. Për më tepër, përvoja tregon se vlera e një kursi të implementuar në një platformë varet jo vetëm nga vlera e veprimtarive individuale dhe burimeve (lënda) të pranishme, por edhe nga fakti se ato janë njëkohësisht të pranishme. Prandaj, në vlerësimin e çdo veprimtarie apo burimi është e përshtatshme të shqyrtojmë nëse, dhe si, integrohet me të tjerat të pranishme. Oferta didaktike duhet të jetë e gjerë dhe të vendosë në lojë materiale dhe veprimtari të ndryshme. Kjo ofertë duhet të jetë e hapur me përdorime të ndryshme sipas nevojave të përdoruesve.

Referenca

- [1] Ferrari, P.L., E-learning e matematica: Rappresentazione e comunicazione in matematica, le potenzialità dell'e-learning. L'educazione matematica. N1/2013 pp. 63-70, 2013.
- [2] Duval, R., *Sémiosis et pensée humaine*, Peter Lang, 1995.
- [3] Bruner, J., *Actual Minds, Possible Worlds*, Cambridge (Massachusetts): Harvard University Press, 1986.
- [4] Bruner, J., *Acts of meaning*, Cambridge (Massachusetts): Harvard University Press, 1990.
- [5] Sfard, A., 'Symbolizing Mathematical Reality Into Being--Or How Mathematical Discourse and Mathematical Objects Create Each Other', in Cobb, P., E. Yackel and K. McClain (eds.), *Symbolizing and Communicating in Mathematics Classrooms*, Mahwah (NJ): Lawrence Erlbaum Associates, 2000.
- [6] Sfard, A., 'There is more to discourse than meets the ears: looking at thinking as communicating to learn more about mathematical learning', *Educational Studies in Mathematics*, 46, 13-57, 2001.
- [7] Duval, R., 'Ecriture, raisonnement et découverte de la démonstration en mathématiques', *Recherches en didactique des mathématiques*, 20/2, 135-169, 2000.
- [8] O'Halloran, K.L., *Mathematical Discourse. Language, Symbolism and Visual Images*. London: Continuum, 2005.
- [9] Ferrari, P.L., *Matematica e linguaggio. Quadro teorico e idee per la didattica*, Bologna: Pitagora Editrice, 2004.
- [10] Halliday, M.A.K., *The Language of Science*. London: Continuum, 2004.
- [11] Vinner, S., 'The Pseudo-Conceptual and the Pseudo-Analytical Thought Processes in Mathematics Learning', *Educational Studies in Mathematics*, 34, 97-125, 1997.



Viti i IX-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2018

UDHËZIME PËR AUTORËT

Materialet (artikujt) i adresohen revistës *OPTIME*. Ato i nënshtrohen vlerësimit të redaksisë, e cila miraton për botim, pasi ka bërë modifikimet eventuale.

Materiali i dërgohet sekretariatit të redaksisë së *Albanian University* në adresën *Bulevardi Zogu I, Tiranë, znj. Eglantina Dervishi, email: egladervishi@yahoo.com dhe Erda Qorri, email: erdaqorri@gmail.com*

Materiali dorëzohet në 3 kopje (një origjinal dhe 2 fotokopje), si dhe në formën elektronike (me disketë). Ai duhet të shoqërohet me adresën e email-it të autorit me të cilin do të lidhet redaksia në vazhdim. Po ashtu, dorëzohet një formular, i cili duhet të firmoset nga autorët e tjerë që i delegojnë autorit kryesor kompetencat. Autorësia nënkupton që secili autor të këtë marrë pjesë në mënyrë të mjaftueshme në punim, aq sa të marrë përgjegjësi publike për përmbajtjen e tij. Renditja e autorëve përcaktohet nga vendimi i përbashkët i bashkautorëve.

Pasi kthehet materiali për rregullime nga autori/autorët, ai ridërgohet në formën përfundimtare.

Drejtskrimi i gjuhës shqipe është i detyrueshëm. Nuk pranohet zëvendësimi i shkronjës **ë** dhe **ç**, përkatësisht me shkronjat **e** dhe **c**.

Materiali duhet të renditet sipas kësaj mënyre:

Faqja e titullit përmban:

Titullin

Emrin /emrat e autorëve (pa titujt shkencorë)

Adresat e të gjithë autorëve. Kur autorët janë në qendra të ndryshme pune, djathtas tyre bëhet një shenjë (që specifikohet më poshtë), p.sh.:

Emër Mbiemër *, Emër Mbiemër **, Emër Mbiemër ***

* Albanin University

** Fakulteti i Mjekësisë i UT

*** Ministria e Shëndetësisë

Adresa e plotë (përfshirë telefonin dhe email-in) e autorit që do të mbajë lidhje me revistën.

Abstrakti

Paraqitet në shqip dhe në versionin anglisht dhe përmban jo më shumë se 250 fjalë. Abstraktit në anglisht i vihet edhe titulli. Në abstrakt paraqitet qëllimi, metodat, rezultatet dhe përfundimet.

Poshtë abstraktit shkruhen fjalët kyçe. P.sh.:

Fjalë Kyçe: revistë, artikull, psikologji.

Materiali

Gjatë shtjellimit të materialit çdo referencë, figurë dhe tabelë numërohet në shifra arabe me numër rendor sipas rendit që citohen në tekst. Kur janë më shumë se 2 referenca, ato ndahen me presje).

Nuk përdoren shkurtime të tjera përveç atyre që janë përdorur në abstrakt.

Falënderimet, nëse ka, shtypen në mbarim të tekstit, pas referencave.

Referencat

Referencat shënohen në tekst me numërorë arabe sipas rendit që citohen.

Referencat shtypen në fletë të veçanta nga teksti me hapësirë dyfishe sipas stilit *Vancouver* (International Committee of Medical Journal Editors Uniform requirements for manuscripts submitted to biomedical journals). Kur lista e autorëve përbëhet nga 1 deri në 7 vetë, citohen që të gjithë. Kur ajo përmban më shumë se 7 vetë, citohen vetëm 3 të parët dhe pas të tretit, shënohet fjala et al. (ose me shkurtimin shqip *e bp.*).

Referencat përshkruhen si më poshtë:

1. Referenca e artikujve periodikë

Autorët ,Titulli, Revista, viti, volumi, faqe, p.sh. :

(1) Quilici J., Gallo R. Physiopatologie des syndromes coronariens aigus. Ann Cardiol. Angeiol 2009;148;611-23.

2. Referenca e një libri

Autori. Titulli, Vendi i botimit, Shtëpia botuese, Viti i botimit.

P.sh.:

(2) Cohen J. Return extrasystoles. New York; Grune and Stratton; 1996.

3. Referenca e një kapitulli libri

Autori kapitullit. Emri kapitullit. Emri i autorit të librit Emri i librit. Vendi i botimit. Shtëpia botuese. Viti botimit; faqet e kapitullit.

P.sh.:

(3) Baillet J. L'apport de la scintigraphie dans le diagnostic de l'embolie pulmonaire. Në: Chiche P La maladie thrombo-embolique pulmonaire Paris; L'Expansion scientifique française; 1969, f. 107-34.

Shkrimet që nuk u përmbahen këtyre udhëzimeve do t'u rikthehen autorëve për rishikim pa u marrë në shqyrtim.

Redaksia

